

VENDIM
Nr. 12, datë 15.1.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1039, DATË 4.12.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË PUNËS DHE PËR ÇAKTIMIN E PËRFAQËSUESVE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NË KËTË KËSHILL”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 200, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1039, datë 4.12.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Punës dhe për caktimin e përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave në këtë këshill”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. KKP-ja kryesohet nga ministri përgjegjës për çështjet e punës dhe ka në përbërje, si përfaqësues të Këshillit të Ministrave, këta anëtarë:

- a) Ministrin e Financave;
- b) Ministrin e Drejtësisë;
- c) Ministrin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
- ç) Ministrin e Arsimit;
- d) Ministrin e Turizmit, Kulturës dhe Sportit;
- dh) Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë;

Përfaqësues kandidatë të KKP-së, në mungesë të përfaqësuesve, anëtarë të Këshillit të Ministrave, janë zëvendësministrat përkatës.”.

2. Në pikën 9 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në shkronjën “b” bëhen këto ndryshime:

i. Fjalja hyrëse ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Komisioni i punësimit, arsimit dhe formimit profesional kryesohet nga drejtori i Drejtorisë së Politikave të Punësimit dhe Migratore në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:”.

ii. Nënndarja “i” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“i. Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, përgjegjësi i sektorit të PAP-së;”.

b) Në shkronjën “c” bëhen këto ndryshime:

i. Fjalja hyrëse ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Komisioni i pagave, pensione dhe përkrahjes sociale kryesohet nga drejtori i Drejtorisë së Politikave të Sigurimeve Shoqërore në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:”.

ii. Nënndarja “i” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“i. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, përgjegjësi i sektorit që mbulon çështjet për mbrojtjen sociale.”.

c) Në shkronjën “ç” bëhen këto ndryshime:

i. Fjalja hyrëse ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Komisioni i kushteve të punës, shëndetit dhe sigurimit në punë kryesohet nga drejtori i Drejtorisë së Marrëdhënieve të Punës, Sigurisë dhe Shëndetit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:”.

ii. Nënndarja “i” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“i. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, përgjegjësi i sektorit që mbulon çështjet e shëndetit dhe sigurisë në punë.”.

ç) Në shkronjën “d” bëhen këto ndryshime:

i. Fjalja hyrëse ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Komisioni i ekonomisë dhe i financës kryesohet nga drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:”.

ii. Nënndarja “i” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“i. Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, përgjegjës i sektorit, Drejtorja e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar;”.

d) Në shkronjën “dh” bëhen këto ndryshime:

i. Fjalja hyrëse ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Komisioni i shanseve të barabarta, aftësive të kufizuara dhe rinisë kryesohet nga drejtori i Drejtorisë së Politikave të Aftësimit Profesional dhe Inspektimit të AFP-së në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:”.

ii. Nënndarja “i” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“i. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, përgjegjës i sektorit që mbulon çështjet për shanset e barabarta dhe aftësitë e kufizuara;”.

3. Kudo në përmbajtjen e vendimit emërtimi “Ministria e Financave dhe Ekonomisë” zëvendësohet me “Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit”.

II. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama